KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

ICEDA
Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda

NOVEMBER
2021

ÇKA KEMI MËSUAR?

E ARDHMJA E "E-LEARNING" NË KOSOVË

This project is co-funded by the European Union

ICEDA
Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda

DEKLARATË MOHIMI

Ky hulumtim është përgatitur si pjesë e projektit "Rritja e Pjesëmarrjes së Qytetarëve në Agjendën Digjitale – ICEDA" me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja është përgjegjësi e Kosova Center for Distance Education (KCDE) - Mëso Online, dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Informata mbi Autorët

Aaron Spitler
Hulumtues, KCDE
aaron.m.spitler@gmail.com

Antigona Uka
Drejtore Ekzekutive, KCDE
antigona.uka@mesoonline-ks.org

Origjinali është shkruar në gjuhën Angleze në kuader të projektit:
"Avokimi për integrimin digjital në sistemin arsimor: Forcimi i arsimit në distancë në Kosovë"

Implementuar nga: KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

Kosova Center for Distance Education-Mëso Online
www.mesoonline-ks.org

E drejta autoriale © 2020 nga KCDE - MESO ONLINE. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të reproduktohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronikapo mekanik, fotokopjues, regjistrues apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Punim Udhëzues

Tashmë dy vite në pandemi dhe mësimdhënësit e Kosovës ende përballen me vështirësi të angazhimit të nxënësve në mësimin digjital apo “e-learning”.

Politikëbërësit janë duke marrur parasysh këtë çështje, dhe kuptojnë se mjetet në dispozicion të mësimdhënësve janë të mangëta. Përderisa kështu mendojnë edhe shumë njerëz të fushës, është me rendësi të kuptohet se cila është përspektiva e vetë mësimdhënësit për rolin e "e-learning" në procesin mësimor. Kësaj pyetjeje ka tentuar t'i përgjigjet Qendra e Kosovës për Arsim në Distancë (KCDE), me crast, në fillim të këtij viti, organizata u kërkoi mësimdhënësve të përshkruanin se si mësimi në distancë ndikoi në punën e tyre në raport me nxënësit. Gjetjet treguan se për të përfituar maximalisht nga e-learning duhet krijuar një mjedis i favorshëm të mësuari.

Meqë digjitalizimi i sektorit ka marrur vëmendje në Prishtinë, zyrtarët duhet të gjejnë kohë për të menduar se si mësimi online mund t'ju shërbejë më mirë shoqërisë në të ardhmën.

Për sa i përket sfidave të mësimdhënësve në Kosovë me mësimin online, shumica shprehën se mungesa e pajisjeve ishte një prej sfidave kryesore. Megjithatë, mungesa e burimeve të shfrytëzueshme nuk ishte problemi i vetëm. Prej rreth 200 mësimdhënësve të anketuar nga KCDE, 46 kanë deklaruar se mosinteresimi i nxënësve ua ka vështirësuar punën. Kjo do të thotë se një e katërta e mësimdhënësve të anketuar menduan se nuk mund të tërhiqnin vëmendjen e nxënësve të tyre gjatë mësimit online. Këto rezultate nuk janë befasuese meqë të shpenzuarit tërë ditën në Zoom ose Hangouts mund të zbehë entuziazmin në orë mësimore. Kjo njëherit tregon se mësimi online është i limituar në video-konferenca dhe zyrtarët në Prishtinë ende nuk e kanë konkretizuar zgjerimin e përkufizimit të tyre për mësimin online apo “e-learning”.

Përshtatja e një strategjie tjetër, si p.sh. mësimi përmes lojërave apo “gamifikimi” ose personalizimi i kurrikulave, mund të ndihmojë në përmirësimin e rezultateve të nxënit.

Pa menduar në mënyrë kreative, politikëbërësit nuk do të jenë në gjendje të korrin përfitimet e këtij formati mësimi.

Problemet me “e-learning” shkojnë përtej përqendrimit të nxënësve. Kur mësimdhënësit u pyetën se çfarë nuk iu pëlqen nga eksperienca me mësimin online, ata theksuan varësinë në teknologji e cila ulë nivelin e interaktivitetit në klasë. Angazhimi i mangët dhe mospërfillja nga nxënësit është përmendur mjaft shpesh si një sfidë e hasur nga mësimdhënësit.

Në rastin më të mirë, përdoruesit përfitojnë nga programet për "e-learning", pasi teknologjitë bëhen mjete me të cilat nxënësit mund të shfaqin aftësitë e tyre në mënyrë kreative pa u varur në teste dhe detyra.

Rezultatet e deritashme tregojnë se zgjidhjet e propozuara nuk janë të mjaftueshme për implementimin e mësimit online sipas standardeve bashkohore. Edhe pse rezultatet nga ky hulumtim janë të kuptueshme, duke konsideruar kufizimet e krijuara nga pandemia, të gjithë akterët relevant të fushës së arsimit kanë të drejtë të presin më shumë nga qeveria. Teknologjitë duhet të integrohen në arsim në një mënyrë që e bën mësimin më dinamik, duke e shtyer procesin e digjitalizimit në Kosovë.

Duke marrë parasysh problemet me mësimin online, shumë në këtë sektor pyesin veten se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar përvojat e mësimdhësve dhe nxënësve. Rezultatet nga sondazhi theksojnë nevojën për ndryshim, pasi të anketuarit renditën rekomandime të cilat variojnë nga përfshirja e mësimeve të përziera "hibride" deri te përmirësimi i infrastrukturës digjitale. Megjithatë, një sugjerim që u përmend nga shumica të anketuarve, më saktësisht nga rreth 57.4% e individëve të përfshirë në studim, ishte trajnimi mbi metodat e mësimit online apo "e-learning".

Nga këto rezultate fillestare mund të nxirren përfundimet në vijim:

1. Kriza e paprecedent ka krijuar nevojën emergjente për përkrahjen e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë dhe mësimit online.
2. Nevojat e mësimdhënësve për ngritjen e shkathësive rreth mësimit online shkojnë përtej atyre bazike (si ngarkimi i materialve në platforma online).

Me fjalë të tjera, një trajnim i strukturuar që inkurajon përdorimin e programeve për "e-learning" është zgjidhje duhur.

Nga këtu e tutje, pyetja mbetë se a do të mund politikëbërësit të mendojnë “përtej kornizave" përderisa përpiqen të përhapin "e-learning" apo zgjidhjet digjitale gjithandej? Aktualisht, duket se liderët të cilët po mirren me këtë çështje po lëvizin në drejtimin e duhur. Për shembull, është formuar një grup punues, i udhëhequr nga figura kyçe në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), për të diskutuar se si të digjitalizohet në mënyrë efektive sektori i arsimit. Pavarësisht vëmendjes që ka marrur mësimi online nga udhëheqësit në qeveri, mbetet për t'u parë nëse do të ndryshojë qasja ndaj mësimit online. Qeveria duhet të mendojë për mënyrat se si këto teknologji mund të tërheqin vëmendjen e nxënësve, dhe se si mund ta bëjnë mjedisin e të mësuarit më dinamik. Në mënyrë kritike, investimet në trajnime specifike do të ndihmonin në realizimin e këtyre synimeve.

Situata me pandeminë i ka dhënë Kosovës mundësinë për të menduar se si mësimi online ose “e-learning” mund të angazhojë dhe frymëzojë nxënës nga të gjitha sferat e jetës.

KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

ICEDA
Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda

This project is co-funded by the European Union

The "Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda – ICEDA" project is implemented by Metamorphosis Foundation (North Macedonia), Open Data Kosovo (Kosovo), e-Governance Academy (Estonia), CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability (Serbia), NGO 35mm (Montenegro), and Levizja Mjaft! (Albania).